



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 31.01.2024 në sallën e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe filloi me punë në orën 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përvendosur tē gjithë tē pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë morën pjesë 17 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 2 asamblistë: Marija Grbiq dhe Marko Arsiq.

Në mbledhje marrin pjesë edhe: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, koordinatorja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mediat (RTV Graçanica), Shërbimi për Informim, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzéri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës tē propozuar për mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar tē ditës:

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzéri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm tē ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 26.12.2022.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tē punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023, me propozim tē kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor tē punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024, me propozim tē kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor tē punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2023, me propozim tē kryetarit të Komitetit për Shërbime Publike, Marko Arsiq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor tē punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, me propozim tē kryetarit të Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë tē rendit tē ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 26.12.2022.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët e pranishëm se për shkak të dështimit të aparatit fotokopjues, shërbimi i asamblesë nuk ka mundur t'u dorëzojë këshilltarëve materialin përmbledhjen në formë fizike, por materiali është dorëzuar vetëm në formë elektronike.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi përvitin 2023, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Koordinatorja e KKSBS-së, Llidija Tokiq, tha se KKSBS-ja ka mbajtur tri mbledhje të rregullta dhe dy të jashtëzakonshme në vitin 2023. Në mbledhje u diskutua për gjendjen e sigurisë, e cila është e paqëndrueshme në Komunën e Graçanicës, si dhe në të gjitha komunat me shumicë serbe, pastaj përfestimin e organizuar të pritjes së Vtitit të Ri, i cili shkoi mirë. Në njëren nga mbledhjet, komandanti i Stacionit policor e prezantoi informacionin se kanë pasur një numër të shtuar të incidenteve-vjedhjeve, ku kryesuesja kërkoi nga Policia, KFOR-i dhe karabinierët që t'i vizitojnë më shpesh fshatrat dhe shtëpitë e largëta që janë të izoluara në fillim apo fund të fshatit ku ndodhin më shpesh vjedhjet. Kryesuesja e ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me situatën aktuale politike dhe të sigurisë në komunat me shumicë serbe. Ajo ka theksuar një sërë incidentesh që kanë ndodhur në Graçanicë, si djegien e flamurit serb pranë monumentit të Millosh Obiliqit, ndërsa në Lipjan është hequr flamuri serb. Ka pasuar edhe të shtëna me armë afër oborrit të shkollës në Uglar, si dhe arrestimi i bashkëqytetarit Dragisha Millenkoviq dhe denoncimi i Burhan Ibrahimit, pjesëtar i nacionalitetit rom, i cili është rrahur nga policia në Graçanicë. Është biseduar edhe përfrojimin me kamerat e sigurisë në Kishnicë, të cilat shpeshherë nuk funksionojnë, si dhe përfshirët nga një veturë në lëvizje afër Qendrës së kulturës në Graçanicë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se raporti duhet te ishte me i përgjithshem dhe më specifik, ndërsa ju e keni tepëruar me detajet, sepse rezulton se në mbledhjet e KKSBS-së, përvèc kryesueses që kryeson, flas vetëm unë dhe ndoshta ndonjëherë edhe anëtari i këshillit z. Todiq, i cili ka qëndrime jo reale (ndërsa si asamblist Dejan Jevtiq), sepse pavarësisht të gjitha situatave që kanë ndodhur në territorin e Komunës së Graçanicës, ai ka shprehur qëndrimin e tij se gjendja është e kënaqshme. Nga raporti nuk mund të konkludohet qëndrimi i këshillit, nëse është dakord se gjendja e sigurisë është e mirë, e keqe apo e kënaqshme. Qëndrimi i anëtarit të KKSBS-së, Sllavisha Todiq, se serbët jetojnë në paqe në territorin e Komunës së Graçanicës dhe se komandanti i Stacionit policor të Graçanicës po e kryen punën e tij në mënyrë fenomenale, nuk është pikë referimi, sepse ai nuk ka iniciuar apo realizuar asnjë projekt, përvèç disa takime simbolike. Në raportin ku është përmendur rasti i djegies së flamurit serb pranë monumentit të Millosh Obiliqit, komandanti i ka kritikuar punonjësit e dyqanit "Jovan" të cilët nuk e kanë rapportuar rastin, ndërsa të gjithë e dimë se dhjetë metra larg atij dyqani qëndron një makinë policie në detyrë gjatë natës. Ajo kërkoi që fjalia që e tha t'i shtohej raportit në atë pjesë, sepse ajo fjali do të tregonte se Policia nuk po e bën punën e saj, por po fle në turn. Në raport nuk thuhet askund se për shkak të situatës së keqe të sigurisë dhe mosveprimit institucional, Zoran Trajkoviq u shpërndau nga Kishnica më 4 gusht.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk është përgjigjur sepse është thirrur nga asamblistja Snezhana, por nuk ka kuptim të thirret Sllavisha Todiq, i cili është një qytetar jashtëzakonisht i nderuar, i ndershëm dhe i respektuar i Komunës së Graçanicës. “Po ashtu qytetarët e dinë se kush jam unë dhe kush është Snezhana”.

Kryesuesi e ndërprenë fjalën e asamblitit Jevtiq, duke i thënë që t'i përmblahej pikës së rendit të ditës.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha se kryesuesi nuk e ndërprenë asamblisten Jovanoviq, e cila foli për gjysmë ore. “Këtu dëgjuam një monolog. Komuna nuk preket nga qëndrimi i saj, e cila në çdo mbledhje përpinqet të ma thërrasë emrin dhe mbiemrin tim si dhe se unë kam një qëndrim të tillë apo të këtillë për sigurinë. Dihet se kush e dorëzon raportin e sigurisë dhe kush kujdeset për sigurinë. Nëse dikush është anëtar i Këshillit të Sigurisë dhe mendon se ka mundësi këtu të thotë atë që ka thënë Snezhana, është fatkeqësia jonë dhe e mjera nëna jonë kur Snezhana është në Këshillin e Sigurisë”.

Kryesuesi e ndërprenë fjalën e asamblitit Jevtiq, duke i dhënë vërejtje publike, pasi nuk iu përbajt pikës së rendit të ditës.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha se kryesuesi nuk ka reaguar kur asamblistja Jovanoviq ia përmendi emrin e tij, si dhe emrin e një njeriu që nuk është i pranishëm.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Koordinatorja e KKSB-së, Llidija Tokiq, tha se Plani i punës i KKSB-së për vitin 2024 është i njëjtë me Planin e punës për vitin 2023, me shtimin e dy aktivitetave “Organizimi i ditëve të komunës” dhe “Organizimi rrëth festave të Vidovdanit”.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2023, me propozim të kryetarit të Komitetit për Shërbime Publike, Marko Arsiq.

Kryesuesi tha se këtë pikë do ta sqarojë asamblisti Stefan Mitroviq, i cili është edhe anëtar i Komitetit për Shërbime Publike, pasi që kryetari i këtij komiteti mungon në mbledhje.

Asamblisti Stefan Mitroviq, para partisë “SRPSKA”, tha se Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme në vitin 2023, gjatë së cilës është diskutuar për problemet e kanalizimeve, shtretërve të lumenjve dhe deponive ilegale. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Vlladica Trajkoviq, i njoftoi asamblitët për këto probleme urgjente dhe e prezantoi planin për zgjidhjen e tyre në të ardhmen. E në të njëjtën kohë, ai u bëri thirrje qytetarëve që mbeturinat mos t'i hedhin në vende ku nuk është paraparë. Anëtarët e komitetit e

vlerësuan punën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, sepse me veprime të ndërmarra parandaluan vërshimet në pjesën e Komunës së Graçanicës ku rrjedh lumi Sitnica, si dhe largimin e deponisë së egër pranë vendkalimit hekurudhor në rrugën Preoc-Lepinë.

Kryesuesi e vlerësoi drejtorit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Vlladica Trajkoviq, sepse është i vetmi që iu përgjigj kërkesave të Kuvendit Komunal.

Në mbledhje është e pranishme asamblistja Marija Grbiq, të pranishëm janë 18 asamblistë dhe ka kuorum.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023, me propozim të kryetarit të Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami.

Kryetari i Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami, tha se Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme në vitin 2023. Në mbledhjet morën pjesë përfaqësuesit e: KFOR-it, "LMT", OSBE-së, UNMIK-ut. Stacioni policor i Graçanicës gjithmonë iu përgjigji thirrjes, ku merre pjesë ose komandanti Bratislav Trajkoviq ose Svetllana Kapetanoviq, zyrtarja e Stacionit policor. Në mbledhjet me ftesë ishin të pranishëm edhe: Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Sllavisha Niçiq; drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Situata Emergjente, Vlladica Trajkoviq, drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim, Planifikim dhe Mbrojtjen e Mjedisit, Aleksandra Gjekiq; drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, Brankica Niqiq; shefja e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Ellvira Kesasi Hoxha; zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Me sugjerim të asamblitit Jevtiq, i cili është edhe anëtar i Komitetit për Komunitete, në mbledhje janë ftuar përfaqësuesit e OJQ-ve "CSD" dhe "Avansojmë së bashku", ku diskutuan për bashkëpunim të mundshëm dhe mundësitë se si sektori joqeveritar mund të përfshihet në projektin konceptual për të zgjidhur problemet dhe vështirësitë e të gjitha komuniteteve.

Konkluzioni: Komiteti për Komunitete, si Komision këshillëdhënës i Kuvendit të Komunës, në vitin 2023 ka arritur të koordinojë në mes banorëve dhe qeverisjes lokale, me ndihmën e anëtarëve të rregullt dhe të Këshillave lokale, të të gjitha komuniteteve, në territorin e Komunës së Graçanicës, dhe në atë mënyrë vepron, përkatesisht ndikon në përhapjen e vëmendjes ndaj problemeve të të gjitha komuniteteve pakicë.

Me shpresën që viti i ardhshëm 2024 të ketë më shumë "vesh" dhe mundësi për kërkesat dhe problemet e përmendura urgjente që do të përfshihen në prioritetin e zbatimit.

Sa i përket sigurisë, ai ka paraqitur informacionin se në vitin 2022 ka pasur 40 raste të dhunës në familje, ndërsa në vitin 2023 kemi pasur 41 raste të dhunës në familje, që është një numër i madh dhe mendoj se duhet të merremi me këtë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Të ndryshme.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët për kritikat e marra nga Ministria e Pushtetit Lokal për punën e Komunës së Graçanicës përmes postës elektronike. Në kërkesë thuhet se ne praktikojmë nepotizëm, se në vendin tonë mungon pushteti, se i diskriminojmë të gjitha komunitetet, veçanërisht atë shqiptar. Kësaj kërkese Komuna e Graçanicës i është përgjigjur me prova materiale se gjithçka që thuhet në kërkesë nuk është e vërtetë. “Këto janë kritika thjesht politike dhe të paargumentuara dhe ne do të përgatisim një përgjigje dhe do të anko hemi edhe te Mbrojtësi i të drejtave të qytetarëve. Përgjigjja përveç ministrisë do t'i përcillet edhe OSBE-së dhe UNMIK-ut, ndërsa asamblistët do të njoftohen me përgjigjen që do ta paraqesim”.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë "SRPSKA", e pyeti kryesuesin nëse mund të thotë se çfarë ka kërkuar MAPL-ja nga Komuna e Graçanicës në atë e-mail.

Kryesuesi u përgjigj se MAPL-ja ka kërkuar nga Komuna e Gracanivës si në vijim:

Se Urbanizmi duhet ta ndalojë masën diskriminuese duke refuzuar dhënien e lejeve ndërtimore palëve, që Zyra e Kadastrës ta bëjë regjistrimin në kohë të rasteve në sistem, që Zyra për Komunitete dhe Kthim të kompletohet me zyrtarët e nevojshëm dhe të riorganizohen vendet e punës, duke përbushur detyrimin për t'i punësuar komunitetet me pakicë. Kryesuesi tha se askush nuk i është përgjigjur konkursit për 3-4 vende pune të shpallur nga Komuna e Graçanicës. Çdo vendim i Kuvendit të Komunës së Graçanicës i dërgohet MAPL--së për vlerësim të ligjshmërisë, që do të thotë se nëse është bërë gabim do të thotë se edhe ata kanë bërë gabim, sepse MAPL-ja duhet t'i shqyrtojë aktet e Kuvendit.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se është në dispozicion përmarrë pjesë në përgatitjen e përgjigjes ndaj kërkesës së MAPL-së.

Asamblisti Granit Gashi, para partisë "Aleanca Shqiptare", e ka pyetur kryesuesin nëse mund t'i sigurohet kërkesa që MAPL-ja i ka dërguar Komunës së Graçanicës për të parë se për çfarë bëhet fjalë.

Kryesuesi u përgjigj se do t'ia përcjellë atë në e-mail.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhia mbaroi në orën 10:45.

Procesmbaitësi:

Производитель:
Agron Karadollami

Ittagorans



Krisëvesi i Kuveprit Komunal

Milan Dimitrijević